



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE

Raporti përfundimtar

Shqyrtimi i Tetë i Tarifave të Energjisë Elektrike

SHTES (2014-2015)

Kalkulimi i MAR-it të KOSTT (Viti Relevant 2)

DEKLARATË

Ky Raporti përfundimtar është përgatitur nga ana e ZRRE-s me qëllim të informimit të palëve të interesuara. Ai nuk paraqet ndonjë vendim të ZRRE-s dhe nuk duhet të interpretohet si tillë.

24 Qershor 2014

Përmbajtja

1	Hyrje	2
2	Përditësimet vjetore dhe përshtatjet e rregullta	2
3	Struktura e këtij raporti.....	5
4	Bilanci Energjetik	5
4.1	Prodhimi i ri i KEK Gjenerimit.....	5
4.2	Humbjet e Lejuara në nivel të transmisionit.....	6
4.3	Humbjet e lejuara në nivel të shpërndarjes.....	Error! Bookmark not defined.
5	Të hyrat e lejuara maksimale për operatorin e sistemit të transmision dhe tregut në Kosovë (KOSTT)	7
5.1	Kostot e lejuara operative dhe të mirëmbajtjes (OPMct)	8
5.2	Kostot e lejuara të zhvlerësimit (DEPct)	9
5.3	Kostoja e lejuar e kthimit të kapitalit (RTNct)	10
5.4	Kostot e lejuara për shërbimet ndihmëse (ASVct)	10
5.5	Kostoja e lejuar e humbjeve (LSSct)	11
5.6	Kostot e lejuara të Licencës (LICct).....	12
5.7	Të hyrat e lejuara për Mekanizmin Kompensues ndër-OST (ITCRt)	12
5.8	Faktori korigjues i të hyrave në vitin relevant t - KREVT	12
6	Përmbledhja e MAR-it të KOSTT-it.....	13



1 Hyrje

Zyra e Rregullatorit të Energjisë aktualisht është në proces të Shqyrtimit të Tetë të Tarifave të Energjisë Elektrike për Furnizuesin Publik me Energji Elektrike (FPEE) dhe Përshtatjet e Rregullta për Vitin e Dytë Relevant të SHTE7 të Shqyrtimit Tarifor për Gjeneratorët e Rregulluar (KEK), Operatorin Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH). Kjo është hera e parë që ZRRE-ja i nënshtrohet një procesi të Përshtatjes së Rregullt me Rregullat e reja për vendosjen çmimeve, proces ky i cili mundëson kontrollin tarifor shumë vjeçar.

Ky raport paraqet vlerësimin e ZRRE-së për MAR-in KOSTT-it që janë kosto të bartshme të Kostot e Blerjes së Energjisë me Shumicë për Vitin e dytë Relevant.

ZRRE ju ka dhënë mundësi të licencuarve që të japin komentet në propozimet e dhëna nga ZRRE-ja në Raportin Fillestar të Vlerësimit. Qëllimi i këtij Dokumenti është që t'u komunikojë palëve të interesit qëndrimet e ZRRE-së lidhur me të hyrat maksimale të lejuara dhe tarifat e rregulluara.

2 Përditësimet vjetore dhe përshtatjet e rregullta

Në vitin 2013, ZRRE-ja ka kryer Procesin e Shqyrtimit Periodik (SHTE7) gjatë të cilit ka caktuar Të Hyrat Maksimale të Lejuara (MAR) për pesë Vitet Relevante të ardhshme për Gjeneratorët e rregulluar (KEK), Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Operatorin e Tregut (KOSTT) dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH). MAR-i për Furnizuesin Publik me Energji Elektrike (FPEE) janë caktuar për një vit gjatë procesit të Shqyrtimit të Vlerave Hyrëse sipas Rregullës për Vendosjen e Çmimeve për Furnizuesin Publik me Energji Elektrike.

Rregulla për Vendosjen e Çmimeve e aprovuar nga ana e ZRRE-s thekson se me qëllim të kalkulimit të ndryshimeve të lejueshme në Të Hyrat Maksimale të Lejuara brenda secilit Vit Relevant duhet të kryhet procesi i Përshtatjeve të Rregullta. Kjo përfshinë përditësimin e humbjeve të lejuara për parashikimin e rrjedhjeve aktuale të energjisë, indeksin për kostot e lejuara Operative dhe të Mirëmbajtjes, Lejimet e Zhvlerësimit dhe Kthimin e Lejuar në raport me inflacionin duke aplikuar faktorët e paracaktuar të efikasitetit për këta të licencuar. Procesi i Përshtatjeve të Rregullta ndryshon nga Shqyrtimi Periodik i tërësishëm gjatë të cilit ZRRE-ja shkon nëpër një shqyrtim të detajuar të Kostove të Lejuara Operative dhe të Mirëmbajtjes, humbjeve të lejuara dhe të faktorëve të efikasitetit dhe Programeve të Lejuara për Shpenzimet Kapitale. Gjatë Përshtatjeve të Rregullta, ZRRE-ja vetëm në mënyrë mekanike bënë përshtatjen e ndryshimeve mes vlerave të lejuara dhe atyre aktuale nga që tanimë janë lejuar gjatë Shqyrtimeve Periodike.

Gjatë Procesit të kaluar të Shqyrtimit Periodik, ZRRE-ja ka përcaktuar nivelin e lejuar të kostove operative dhe të mirëmbajtjes, shpenzimet kapitale të lejuara, faktorët e efikasitetit, jetëgjatësinë Ekonomike të Aseteve, faktorët e profilizimit dhe koston mesatare të ponderuar të kapitalit dhe normene e interesit për gjeneratorë e rregulluar, KOSTT dhe OSSH. Prandaj, niveli i përgjithshëm i këtyre lejimeve nuk është temë për diskutime gjatë procesit të Përshtatjeve të Rregullta. Sa i përket parimeve të Rregullës për Vendosjen e Çmimeve, gjatë Përshtatjeve të Rregullta, ZRRE-ja do të:



1. Caktoj indeksin për Kostot e Lejuara Operative dhe të Mirëmbajtjes për të gjithë operatorët e licencuar për Faktorin e Efikasitetit i cili caktohet gjatë procesit të Shqyrtimit Periodik dhe për Inflacionin Vjetor i cili caktohet duke përdorur Indeksën e Harmonizuar të Çmimeve për Konsumatorë (IHÇK) për të gjithë artikujt në Eurozonë;
2. Caktoj caqet e Disponueshmërisë për Gjeneratorët e Rregulluar;
3. Caktoj Ngarkesat e Energjisë dhe Ngarkesat e Kapacitetit për Gjeneratorët e rregulluar;
4. Përditësoj Kostot e Lejuara për Furnizim me Thëngjill (LGSCt) për Gjeneratorët e Rregulluar. Ky përditësim përfshinë kostot e paracaktuara Operative dhe të Mirëmbajtjes, Zhvlerësimin dhe Kthimin e Lejuar për Mihjet duke përcjellë parimet e njëjta sikur për Gjeneratorët e Rregulluar. Kostot e paracaktuara për LGSCt përfshijnë ndryshimin mes kostove aktuale dhe të lejuara për furnizim me thëngjill gjatë Vitit Relevant të parë të Periudhës Rregullative;
5. Përditësoj Kostot për Lëndët Tjera Djegëse (OTFct) për Gjeneratorët e Rregulluar duke përfshirë ndryshimin me kostove të lejuara dhe aktuale gjatë Vitit Relevant të parë të Periudhës Rregullative;
6. Llogaris Kostot e Shitjeve me Shumicë të Energjisë të cilat përfshijnë koston e energjisë së blerë nga Gjeneratorët e Rregulluar, nga Importet dhe Margjina e Shitjeve me Pakicë. Këto përditësime kanë për qëllim reflektimin e ndryshimeve mes kostove të lejuara dhe aktuale të blerjes së energjisë në Periudhën Paraprake Rregullative;
7. Caktoj Kostot e Lejuara të Humbjeve (LSSct) për Sistemin e Transmisionit dhe Operatorin e Tregut dhe përditësimin e tyre duke përfshirë ndryshimin mes kostove të lejuara dhe atyre aktuale për Periudhën paraprake Rregullative të cilat mund të jenë rritur për shkak të ndryshimeve në kostot e shitjeve me shumicë të energjisë apo për shkak të ndryshimeve në rrjedhjen e energjisë elektrike në sistemin e transmisionit;
8. Përditësoj MAR-in për OST-në për të reflektuar të hyrat e gjeneruar përmes Mekanizmit për Kompensime Ndërmjet TSO-ve;
9. Përditësoj MAR-in për TSO për të reflektuar ndryshimet mes Të Hyrave të Lejuara dhe të Hyrave Aktuale të Rregulluara në Vitin Relevant paraprak (t-1);
10. Llogarisë Mbitaksën për Energjinë e Ripërtëritshme që do të shfrytëzohet për financimin e Fondit për Energji të Ripërtëritshme (FER) me qëllim të pagesës së Tarifave Nxitëse (Feed-in Tariffs) për Gjeneratorët e BRE të pranuar në Skemën Mbështetëse për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (BRE);
11. Caktoj Ngarkesat për Shfrytëzimin e Sistemit të Transmisionit, Operatorin e Tregut dhe Operatorin e Sistemit;
12. Caktoj e Kostot e Lejuara nga Humbjet (LSSct) për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) dhe përditësimin e tyre duke përfshirë ndryshimet mes kostove të lejuara dhe aktuale nga humbjet për Periudhën paraprake Rregullative që mund të dalin për shkak të ndryshimeve në kostot e shitjeve me shumicë të energjisë apo për shkak të ndryshimeve në rrjedhjen e energjisë elektrike në sistemin e Shpërndarjes.
13. Përditësoj MAR-in e OSSH-s për të reflektuar ndryshimin në mes Të Hyrave të Lejuara dhe Aktuale të Rregulluara në Vitin Relevant paraprak (t-1);
14. Caktoj Ngarkesat për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes;



15. Llogaris Kostot e Lejuara të Shitjeve me Pakicë për Furnizuesin Publik me Energji Elektrike që përfshijnë kostot operative dhe të mirëmbajtjes së aktiviteteve të FPEE, kostot e korporatës, lejimet e zhvlerësimit dhe kostot tjera të arsyeshme të FPEE;
16. Caktoj MAR-in e ri të FPEE duke përfshirë ndryshimin mes faturimit të lejuar dhe aktual gjatë Periudhës paraprake Rregullative;
17. Caktoj Tarifa të reja për Shitjet me Pakicë për konsumatorët e rregulluar tarifor;



3 Struktura e këtij raporti

Raporti Konsultativ është i strukturuar si vijon:

- Seksioni 4 paraqet Bilancin Energjetik të supozuar nga ana e ZRRE-s për Vitin e dytë Relevant të Periudhës Rregullative;
- Seksioni 5 paraqet Të hyrat e lejuara maksimale për operatorin e sistemit të transmision dhe tregut në Kosovë (KOSTT)

4 Bilanci Energjetik

Bilanci Energjetik paraqet një kontribut kyç në procesin e përcaktimit të tarifave dhe si i tillë ka ndikimin më të madh në koston e ofrimit të Shërbimeve të Rregulluara në sektorin e energjisë elektrike. Bilanci Energjetik në modelin e ZRRE-s ka shfrytëzuar kontributet nga Bilanci Energjetik i aprovuar nga ana e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (MZHE) për vitin 2014. Bilanci Energjetik është konstruktuar duke përdorur qasjen poshtë-lartë ku vlera e parashikuar e shitjeve në nivel të shpërndarjes është përdorur si pikë fillimi. Mandej, për të llogaritur sasinë e energjisë së kërkuar për hyrje në sistemin e shpërndarjes është përdorur përqindja e humbjeve të lejuara në rrjetin e shpërndarjes nga gjeneratorët e shpërndarjes. Kërkesa në nivel të transmisionit, humbjet dhe eksportet i janë shtuar konsumit të shpërndarjes. Ndryshimi mes vlerës rezultuese dhe gjenerimit vendor (Gjenerimi i KEK-ut dhe Ujmanit) paraqet vëllimin e importeve që kërkohen për të balancuar prodhimin dhe kërkesën për energji.

4.1 Prodhimi i ri i KEK Gjenerimit

Gjatë periudhës konsultative ZRRE mbajtur takime të shumta me KEK për të shqyrtuar mundësinë e zhvendosjes së planit të remontit të Gjeneratorit A5 për vitin e tretë relevant tarifar. Ky remont ishte planifikuar të ndodhte gjatë Vitit të parë të Periudhës Rregullative por KEK nuk ka arritur të kryejë remontin sipas orarit të planifikuar. Kjo ka rezultuar që remonti i asaj njësie të shtyhet për vitin e dytë Relevant kur pritet të hyjnë në remont edhe njësitë e tjera gjeneruese. Zhvendosja nga funksionimi i këtyre njësive gjeneruese në të njëjtën periudhë kohore do të rezultonte në mungesë të konsiderueshme të prodhimit nga Gjeneratorët vendorë që rrjedhimisht do të ndikonte në rritje të ndjeshme të vëllimit të energjisë së importuar.

ZRRE ka propozuar që remonti i njësisë A5 të shtyhet për vitin e ardhshëm Relevant në mënyrë që pjesëmarrja e gjenerimit vendor në këtë vit të jetë më e madhe. Kjo ka ndikuar që prodhimi vendor të rritet për 170 GWh në krahasim me vlerën e dhënë në Balancën e aprovuar të Energjisë. Gjithsesi ndryshimet në mes të vlerave të parashikuara dhe të realizuara do të përshtaten përmes WHPC në Përshtatjet e Rregullta të vitit të tretë relevant.



4.2 Humbjet e Lejuara në nivel të transmisionit

Humbjet e Lejuara në Nivel të Transmisionit janë caktuar të jenë 1.8% të nxjerra gjatë Procesit të Shqyrtimit Periodik.

Duke përdorur bilancin energjetik të aprovuar për shitjet e pritura për vitin 2014 dhe duke vazhduar nga ai përmes humbjeve në nivel të shpërndarjes, vlera e energjisë e cila futet në sistemin e shpërndarjes për furnizimin e konsumatorëve të rregulluar ishte llogaritur të jetë 4,495.4 GWh. Kërkesat për furnizim në nivel të transmisionit (Ferronikeli, Sharrcem dhe Trepça), eksportet e energjisë elektrike, konsumi i LOMAG-ut dhe humbjet në nivel të transmisionit së bashku arrijnë shumën 1,608 GWh. Gjenerimi i KEK-ut, Ujmani dhe gjeneratorët e vegjël të kyçur në nivel të shpërndarjes pritet që së bashku të prodhojnë 5,653.3 GWh. Ndryshimi mes konsumit dhe prodhimit do të mbulohet përmes importit në vlerë prej 450.3 GWh. Bilanci energjetik i llogaritur nga ZRRE-ja është përmbledhur në tabelën në vijim:

Tabela Bilanci Energjetik 2014

Bilanci Energjetik		SHTE7 LLejuar	SHTE7 Aktual	SHTE8 (2014-2015) Lejuar
KEK Gjenerimi		5,592.0	5,877.5	17 5,525.0
Kosova A	GWh	1,848.0	2,014.0	1,929.0
Kosova B	GWh	3,744.0	3,863.4	3,595.95
Gjeneratorët e Kyçur në Transmision				
HC Ujmani	GWh	80.0	99.4	82.0
Konsumi i kyçur në Transmision				
Ferronikeli	GWh	527.0	403.2	526.7
Trepça	GWh	94.9	84.0	27.1
Sharrcem	GWh			63.3
Konsumi tjetër në nivel të Transmision				
Konsumi në Miniera	GWh	140.0	128.5	138.0
Furnizimi për Kosovën A nga Transmisioni	GWh	72.0	107.2	53.2
Furnizimi për Kosovën B nga Transmisioni	GWh	83.0	51.4	91.9
Humbjet në Transmision				
	%	1.8%	1.7%	1.8%
	GWh	111.2	110.3	109.0
Hyrjet e Energjisë në sistemin e Transmisionit				
Ekporti	GWh	492.0	857.0	599.0
Prodhimi Total				
	GWh	5,672.0	5,976.9	5,607.0
Importi				
	GWh	505.0	521.4	450.3



Kërkesa për Energji për mbulimin e konsumit (ngarkesës) në Transmision	GWh	1,520.1	1,741.6	1,608.2
Kërkesa për Energji për mbulimin e konsumit (ngarkesës) në Shpërndarje	GWh	4,656.9	4,750.3	4,449.1
Gjenerimi në Shpërndarje				
Gjenerimi i kyqur në Shpërndarje	GWh	35.0	43.9	46.3
Wind Power Sh.A	GWh			
Konsumi në Shpërndarje	GWh	4,691.9	4,794.2	4,495.4
Humbjet në Shpërndarje dhe energjia e pa faturuar				
Humbjet teknike dhe komerciale	%	27.4%	32.5%	25.6%
	GWh	1,227.5	1,485.9	1,098.2
Furnizimi i pa faturuar	%	4.52%	4.55%	4.69%
	GWh	212.0	218.2	211.0
Humbjet totale	GWh	1,439.5	1,704.1	1,309.2
Shitjet te konsumatorët fundor	GWh	3,252.4	3,090.1	3,186.2

5 Të hyrat e lejuara maksimale për operatorin e sistemit të transmision dhe tregut në Kosovë (KOSTT)

Të hyrat e lejuara maksimale për operatorin e sistemit të transmision dhe tregut në Kosovë (KOSTT) caktohen gjatë Shqyrtimeve Periodike për të gjitha Vitet Relevante të Periudhës Rregullative sipas Rregullës për Çmimet e OST/OT-së. Gjatë shqyrtimeve periodike, ZRRE-ja përcakton komponentët kryesore për MAR-in e KOSTT-it duke përfshirë Kostot e përgjithshme të lejuara Operative dhe të Mirëmbajtjes, Zhvlerësimin dhe Kthimin e Lejuar. Këto komponentë gdhenden dhe profilizohen për të ju shmangur ndryshimeve të paparashikuara të kostove të cilat të cilat përndryshe, do të ndodhnin për shkak të ndryshimeve në nivelin e programeve të shpenzimeve kapitale.

Ndryshimet e lejuara në MAR llogariten gjatë Përshtatjeve të Rregullta gjatë të cilave ZRRE-ja cakton indeksin e kostove të lejuara për inflacion duke aplikuar faktorin e paracaktuar të efikasitetit për kostot operative dhe të mirëmbajtjes. ZRRE-ja i mundëson KOSTT-it kompensimin për ndryshimet mes kostove të lejuara dhe atyre aktuale për të cilat konsiderohet të jenë përtej kontrollit të KOSTT-it. Një nga kostot e tilla janë kostot nga humbjet ku ZRRE-ja i kompenson KOSTT-it ndryshimet mes kostot e lejuara dhe aktuale që mund të kenë ndodhur për shkak të ndryshimit mes rrjedhjes së energjisë elektrike të parashikuar dhe asaj aktuale apo për shkak të ndonjë ndryshimi në kostot për njësi të një njësie të humbur.

Gjatë secilës Përshtatje të Rregullt, MAR-i i KOSTT-it rivendoset sipas formulës në vijim (Shtojca 1, paragrafi 2 i Rregullës për Çmimet e OST/OT-së):

$$MAR_t = OPMC_t + DEPC_t + RTNC_t + ASVC_t + LSSC_t + LICC_t - ITCR_t + KREV_t$$



Ku:

MAR_t	<i>Të hyrat e lejuara maksimale në vitin relevant t</i>
$OPMC_t$	<i>Kostot operative dhe të mirëmbajtjes në vitin relevant t</i>
$DEPCt$	<i>Zhvlerësimi i lejuar në vitin relevant t</i>
$RTNCT$	<i>Kthimi i kostos së kapitalit i lejuar në vitin relevant t</i>
$ASVCT$	<i>Kostot e lejuara për shërbime ndihmëse në vitin relevant</i>
$LSSCt$	<i>Kostoja e lejuar e humbjeve në vitin relevant t</i>
$LICCT$	<i>Kostoja e taksës për licencë në vitin relevant t</i>
$ITCRt$	<i>Të hyrat neto të OST/OT nga mekanizmi kompensues ndër-OST në vitin relevant t</i>
$KREVT$	<i>Faktori korrigjues i të hyrave në vitin relevant t</i>

Më poshtë është dhënë llogaritja e secilës komponentë të MAR-it.

5.1 Kostot e lejuara operative dhe të mirëmbajtjes (OPMCt)

Kostot operative dhe të mirëmbajtjes caktohen gjatë secilës Përshtatje të Rregullt përmes formulës në vijim (Shtojca 1, paragrafi 2.1 Rregullës për Çmimet e OST/OT-së):

$$OPMC_t = OPMC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - E_t) * (1 - P_t)$$

Ku:

$OPMCt$	<i>Kostot operative dhe të mirëmbajtjes në vitin relevant t</i>
$OPMCt-1$	<i>Kostot operative dhe të mirëmbajtjes në vitin relevant t, përveç në vitin relevant 1, ku do të përdoret një vlerë e përcaktuar nga rregullatori që bazohet nga shqyrtimi më i vonshëm periodik</i>
CPI_{t-1}	<i>Vlera e realizuar e inflacionit në vitin relevant t-1, matur duke përdorur Indeksin e harmonizuar të çmimeve të konsumit (HICPs) – për të gjitha njësitë në Eurozonë, të publikuar nga Eurostat-i, apo ndonjë vlerësim tjetër i inflacionit që rregullatori e përcakton si masën më të mirë të ndryshimit në kostot e operimit dhe mirëmbajtjes gjatë kohës dhe i cili është lejuar gjatë shqyrtimit periodik</i>
E_t	<i>Faktori i efikasitetit në vitin relevant t, që caktohet gjatë shqyrtimeve periodike</i>



Pt Faktori profilizues në vitin relevant *t*, që caktohet gjatë shqyrtimeve periodike

Kostot operative dhe të mirëmbajtjes për vitin e dytë relevant llogariten si shumë e shifrës së lejuar nga ana e ZRRE-s në Modelin Përmbledhës të shumëzuar me shkallën e inflacionit plus kostot e lejuara operative dhe të mirëmbajtjes për Vitin e dytë Relevant. Nëse kjo llogaritje është bërë sipas formulës së dhënë në Rregullën për Çmimet e OST/OT-së atëherë OST/OT nuk do të jetë në gjendje të kthejë kostot e lejuara për operative dhe të mirëmbajtjes (KOPM) sepse, formula supozon se lejimet për KOPM profilizohen përgjatë Periudhës Rregullative. Meqë ZRRE-ja nuk ka bërë profilizimin e OPMCT gjatë Shqyrtimit Periodik, atëherë OPMCT duhet llogaritur si shumë e prodhimit të shkallës së inflacionit me OPMCT paraprake të lejuar (në Vitin Relevant 1) dhe lejimet e OPMCT për Vitin Relevant 2. ZRRE-ja ka vazhduar të aplikojë faktorin e efikasitetit të caktuar gjatë Shqyrtimit Periodik prej 4% në vit dhe shkallën e inflacionit prej 0.7% e llogaritur si Indeks i Harmonizuar i Çmimeve për Konsumatorë për të gjithë artikujt në Eurozonë.

Prandaj, ZRRE-ja ka llogaritur lejimet për OPMCT për Vitin e Dytë Relevant të KOSTT-it sipas formulës në vijim:

$$OPMC = OPMC_{t-1} * (CPI_{t-1}) * (1 - E_t) + OPMC_t$$

Niveli i lejuar i OPMCT është €7.1 milion.

5.2 Kostot e lejuara të zhvlerësimit (DEPCt)

Ndryshimet që lejohen në Kostot e lejuara të zhvlerësimit caktohen gjatë secilës Përshtatje të Rregullt përmes formulës në vijim (Shtojca 1, paragrafi 2.2 Rregullës për Çmimet e OST/OT-së):

$$DEPC_t = DEPC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t)$$

Ku:

DEPCt Zhvlerësimi i lejuar në vitin relevant *t*, që është zbutur ashtu që të jetë konstant gjatë periudhës rregullative

DEPCt-1 Zhvlerësimi i lejuar në vitin relevant *t*, përveç në vitin relevant 1, ku do të përdoret një vlerë e përcaktuar nga rregullatori që bazohet nga shqyrtimi më i vonshëm periodik dhe që është zbutur ashtu që të jetë konstante gjatë periudhës rregullative

CPIt-1 Vlera e realizuar e inflacionit në vitin relevant *t-1*, matur duke përdorur Indeksin e harmonizuar të çmimeve të konsumit (HICPs) – për të gjitha njësitë në Eurozonë, të publikuar nga Eurostat-i

Pt Faktori profilizues në vitin relevant *t*, që caktohet gjatë shqyrtimeve periodike

Formula, siç është caktuar në Rregullën për Çmime, supozon se kostot e lejuara të zhvlerësimit gdhenden dhe profilizohen gjatë periudhës rregullative. Meqë gjatë Periudhës së Shqyrtimit Periodik



nuk është bërë ndonjë rregullim, atëherë aplikimi i saktë i formulës sipas Rregullës për Çmimet nuk do të përputhej me lejuimet e synuara të DEPCt për vitin e dytë relevant. Prandaj ZRRE-ja ka miratuar formulën në vijim:

$$DEPC = DEPC_{t-1} * (CPI_{t-1}) + DEPC_t$$

Kostot e lejuara të Zhvlerësimit për Vitin Relevant 2 janë caktuar të jenë €6.6 milion.

5.3 Kostoja e lejuar e kthimit të kapitalit (RTNCt)

Indeksi i komponentës së Kthimit të Lejuar ndaj inflacionit llogaritet sipas formulës në vijim (Shtojca 1, paragrafi 2.3 i Rregullës për Çmimet e OST/OT-së):

$$RTNC_t = RTNC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t)$$

Ku:

<i>RTNCt</i>	<i>Kthimi i lejuar i kapitalit në vitin relevant t, që është zbutur ashtu që të jetë konstant gjatë periudhës rregullative</i>
<i>RTNCt-1</i>	<i>Kthimi i lejuar i kapitalit në vitin relevant t, përveç në vitin relevant 1, ku do të përdoret një vlerë e përcaktuar nga rregullatori që bazohet nga shqyrtimi më i vonshëm periodik dhe që është zbutur ashtu që të jetë konstant gjatë periudhës rregullative</i>
<i>CPIt-1</i>	<i>Vlera e realizuar e inflacionit në vitin relevant t-1, matur duke përdorur indeksin e harmonizuar të çmimeve të konsumit (HICPs) – për të gjitha njësitë në Eurozonë, të publikuar nga Eurostat-i</i>
<i>Pt</i>	<i>Faktori profilizues në vitin relevant t, që caktohet gjatë shqyrtimeve periodike</i>

Në të dy rastet e llogaritjes së komponentëve të OPMct dhe DEPCt, ZRRE-ja, gjatë Shqyrtimit Periodik, nuk ka bërë profilizimin apo rregullimin e Kthimit të Lejuar. Formula e lartpërmendur supozon se komponenti për kthimin e lejuar është profilizuar prandaj, aplikimi i saktë i saj qon në situatën ku OST/OT nuk i mbulon kthimin e tërësishëm të lejuar. Prandaj kjo komponentë është llogaritur sipas formulës në vijim:

$$RTNC = RTNC_{t-1} * (CPI_{t-1}) + (RTNC_t)$$

Kthimi i lejuar për OST/OT për Vitin e dytë Relevant është caktuar në shumë prej €3.3 milion.

5.4 Kostot e lejuara për shërbimet ndihmëse (ASVct)

Sipas aplikimit të KOSTT, taksat për Shërbimet Ndhmëse pritet të hynë në fuqi nga ky vit për shkak të marrëveshjes e cila pritet të nënshkruhet me Serbinë. KOSTT-i pret që kjo vlerë të jetë afërsisht e njëjtë me vlerën e lejuar për vitin paraprak prej €1.6 milion. Gjatë një takimi të mbajtur më 26 mars 2014, KOST-i ka theksuar se marrëveshja ende nuk është nënshkruar dhe nuk e dinin se kur mund të



bëhej nënshkrimi i marrëveshjes. Ndërkohë janë mbajtur edhe takime të tjera dhe deri në momentin e aprovimit të MAR-it për KOSTT, marrëveshja në fjalë nuk është nënshkruar.

Në mungesë të informatave për kostot e sakta të këtyre shërbimeve dhe të hyrave që lidhen me transitin të cilat KOSTT-i pret t'i inkasojë pas nënshkrimit të marrëveshjes, ZRRE-ja, në këtë fazë, nuk do t'i lejojë kostot nga Shërbimet Ndihmëse (Ancillary Services) për Vitin e dytë Relevant. ZRRE-ja do të bëjë shqyrtimin e çfarëdo ndryshimi mes kostove të lejuara dhe atyre aktuale gjatë Përshtatjes së Rregullt vijuese.

5.5 Kostoja e lejuar e humbjeve (LSSCt)

Kostoja e lejuar e humbjeve për OST-n është llogaritur duke përdorur cakun e lejuar të humbjeve gjatë SHTEE7 me rrjedhjen e energjisë para raportit sqarues (Humbjet e OSSH-s prej 27.4%, humbjet e OST prej 1.8%) duke përdorur formulën në vijim (Shtojca 1, paragrafi 2.4 i Rregullës për Çmimet e OST/OT-së):

$$LSSC_t = LSSA_t * REUE_t * WHEA_t + (LSSCa_{t-1} - LSSCf_{t-1}) * (1 + I_t) + (LSSCa_{t-1} - LSAC_{t-1}) * LSSF_t$$

Ku:

LSSCt Kostoja e lejuar e humbjeve për vitin relevant t

LSACt Humbjet e lejuara, që janë paraqitur si përqindje e energjisë që hyn në sistemin e transmisionit në vitin relevant t

REUEt Njësiti e energjisë (MWh) që hyjnë në sistemin e transmisionit në vitin relevant t

WHEAt Mesatarja e kostos me shumicë të energjisë (€/MWh) e përcaktuar duke përdorur kostot e lejuara me shumicë për FPEE në vitin relevant t

LSSCat-1 Koston e realizuar të humbjeve të lejuara në vitin relevant t-1, (llogaritur duke përdorur humbjet e lejuara)

LSSCft-1 Kostoja e parashikuar e humbjeve në vitin relevant t-1, (llogaritur duke përdorur humbjet e lejuara)

It Norma e interesit për vitin relevant t, që llogaritet bazuar në EURIBOR plus S%, ku S paraqet vlerën e përcaktuar nga ZRRE-ja gjatë shqyrtimeve periodike që reflekton preminë e pagueshme nga i licencuari për hua afatshkurtra

LSACt-1 Koston e humbjeve të realizuara gjatë blerjes së energjisë nga PES si kompensim të energjisë së humbur në rrjetin e transmisionit (nuk llogaritet duke përdorur humbjet e lejuara) në vitin relevant t-1



LSSFt Faktori i ndarjes së humbjeve në vitin relevant t, që caktohet gjatë shqyrtimeve periodike

Norma e interesit e përdorur për llogaritjen e kompensimit mes kostot aktuale dhe të lejuara në Vitin Relevant paraprak është llogaritur duke përdorur S-preminë të caktuar nga ana e ZRRE-s gjatë Shqyrtimit Periodik (15.0%) plus normën aktuale vjetore të EURIBOR (0.58%). Prandaj norma e interesit dalë si rezultat i kësaj prej 15.58% është përdorë për përshtatjet.

Komponenta e parë e formulës së kostove të lejuara të humbjeve (LSSAt*REUEt*WHEAt) është llogaritur si prodhim i kostove të lejuara (1.8%) shumëzuar më njësitë e energjisë që hyjnë në sistemin e shpërndarjes (6,057.2 GWh) dhe parashikimet për Çmimin Mesatar të Ponderuar të Kostove të Blerjes së Energjisë prej 27.3 €/MWh. Kostoja aktuale e humbjeve (LSSCat-1) duke përdorur përqindjen e humbjeve të lejuara nga ZRRE-ja dhe mesataren e kostos me shumicë të energjisë (WHEA) e lejuar nga ZRRE-ja prej €3.5 milion ndërsa vlera aktuale e lejuar nga ZRRE-ja (LSSCft-1) në Vitin Relevant 1 e MAR-it është €3.4 milion. Ndryshimi mes LSSCat-1 dhe LSSCft-1 i është kthyer KOSTT-it me kamatë. Gjatë rivendosjes së humbjeve të lejuara për Vitin e dytë Relevant (LSSCt), ZRRE-ja ka shtuar edhe ndryshimin mes LSSCat-1 dhe LSSCft-1. Kostot e lejuara janë përshtatur për të reflektuar ndryshimin mes humbjeve të lejuara dhe humbjeve komerciale (CL). Prandaj, kostot e lejuara përfundimtare të humbjeve për OST për Vitin e dytë Relevant janë €3.3 milion.

5.6 Kostot e lejuara të Licencës (LICCt)

Kostot e lejuara të licencës janë caktuar të jenë zero në linjë me kostot e pritura të licencës për Vitin e dytë Relevant tarifor.

5.7 Të Hyrat e lejuara për Mekanizmin Kompensues ndër-OST (ITCRt)

Për Mekanizmin Kompensues ndër-OST (ICT) nuk është bërë zbritje e të hyrave sipas të hyrave të pritura në kuadër të këtij mekanizmi për Vitin e dytë Relevant.

5.8 Faktori korigjues i të hyrave në vitin relevant t - KREVt

Ndryshimi mes të hyrat e lejuara maksimale (MAR) të caktuara nga ana e ZRRE-s për Vitin e dytë Relevant dhe Të Hyrat Aktuale të Rregulluara që inkasohen nga KOSTT-i gjatë së njëjtës periudhë, është llogaritur sipas formulës në vijim (Shtojca 2, paragrafi 2.5 i Rregullës së Çmimit të OST/OT-së):

$$KREV_t = (MAR_{t-1} - ARR_{t-1}) * (1 + I_t)$$

Ku:

ARRt-1 Paraqet të hyrat aktuale të rregulluara në vitin relevant t-1

MARt-1 Paraqet të hyrat e lejuara maksimale për vitin relevant t-1

It Është norma e interesit për vitin relevant t, që llogaritet bazuar në EURIBOR plus 5%, ku S paraqet vlerën e përcaktuar nga ZRRE-ja gjatë shqyrtimeve periodike që reflekton preminë e pagueshme nga i



licencuari për hua afatshkurtra

Ndryshimi mes MAR-it të lejuar nga ZRRE-ja prej €17.5 milion dhe ARR-së së faturuar nga ana e KOSTT-it prej €17.7 milion është zbritur nga MAR i KOSTT-it me kamatë.

5.9 Përmbledhja e MAR-it të KOSTT-it

Niveli i përgjithshëm i lejuar i MAR-it për KOSTT për Vitin e dytë Relevant është €20.2 milion që është për €2.6 milion më i lart se sa MAR-i i lejuar për vitin e parë relevant të Periudhës Rregullative tarifore.

Tabela: Përmbledhja e MARit të KOSTT-it

MAR-i i KOSTT-it		SHTE7 I lejuar	SHTE8 I lejuar
Parametrat e Indeksimit			
Faktori i Efikasitetit	%		4.00%
Faktori i Profilizimit			0.00
HICP-Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit	%		0.70%
Euribor	%		0.58%
S-factor	%		15.00%
It-Notma e Interesit	%		15.58%
Shpenzimet Operative dhe të Mirëmbajtjes (OPMCt)			
$OPMC_t = OPMC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - E_t) * (1 - P_t)$	€m	7.2	7.1
Zhvierësimi i Lejuar (DEPCt)			
$DEPC_t = DEPC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t)$	€m	5.2	6.6
Kthini i Lejuar (RTNCt)			
$RTNC_t = RTNC_{t-1} * (1 + CPI_{t-1}) * (1 - P_t)$	€m	1.6	3.3
Humbjet e Lejuara (LSSCt)			
Humbjet e Lejuara			
LSSAt	%	1.8%	1.8%
REUEt	GWh	6,177.0	6,057.2
WHEAt	€/MWh	30.2	27.3
LSSCat-1			
LSSCft-1		3.4	
LSACt-1	€m		
LSSCt	€m	3.4	3.3
Azurnimi për arritjen e caqeve të humbjeve			
			0.20
KREV - Faktori Korigjues i të Hyrave			
	€m		-0.2
MAR-i i KOSTT-it			
Përshtatjet/Azurnimet	€m	0.1	
	€m	17.5	20.2